"B U K A" sh.a

Raporti i Auditorit të Pavarur

Mbi Pasqyrat Financiare për vitin

e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Shoqeria "BUKA" Sh p k
Shenime per Deklarimet Financiare
Per periudhen 1 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2021
(Shumat ne Leke)

1. Te pergjithshme

Shoqëria BUKA sha është themeluar me datë 17/10/1995 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës. Ajo është shoqëri e formës *Shoqëri Aksionare .*
Objekti i saj kryesor eshte "Shfrytezimi i aseteve dhe pasurive te paluajtshme te Shoqerise; dhenia e tyre me qera ne pale te treta; perdorimi per nevoja te veta te depove, magazinave, ndertesave, apo dhenia me qera e tyre paleve te treta; Magazinimi i produkteve te ndryshme ne ndertesat dhe asetet e Shoqerise per nevojat e veta; apo me qera ne favor te paleve te treta; Tregtia me shumice dhe/ose e pakice e te gjitha mallrave te te gjitha Llojeve; Aktivitet Import dhe/ose Eksport te mallrave dhe te mirave materiale te te gjitha llojeve; Aktivitet ndertimi dhe konstruksioni i godinave rezidenciale, qendrave tregetare, dhe strukturave te ndryshme; Ativiteti i manaxhimit, shitjes, dhenies me qera, administrimit per nevoja te shoqerise apo ne favor te te treteve te pasurive te paluajtshme, apo tyre te luajtshme; Aktiviteti i konsulences ne fushen e pasurive te paluajtshme; Konsulence dhe aktivitet tregetar ne fushen e arkitektures, inxhinierise se ndertimit; Aktivitete bar-restorant-klub-klub nate; dhe tregetimi i te gjitha produkteve ushqimore, gatimeve, pijeve te te gjitha llojeve, pa u kufizuar ne pije alkoolike, etj. Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve pa kufizim; tregetimi, manaxhimi dhe administrimi i kesaj industrie; Organizimi, manaxhimi dhe administrimi i industrive zbavitese te te gjitha llojeve dhe per te gjitha moshat dhe shtresat, pa kufizime; Organizimi i te gjitha akviteteve kreative dhe zbavitese per te gjitha moshat dhe shtresat; organizimi, manaxhimi dhe administrimi i aktiviteteve artistike dhe kulturore; Prodhimin, shitjen me shumice apo pakice te bukes, te te gjitha llojeve, te majase se bukes, dhe produkteve te tjera te ngjashme nga perpunimi i miellit; Te gjitha dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, ne perputhje me ligjet e Republkes se Shqiperise.

Administrator i Shoqerise eshte Z. Gezim Besholli.

Adresa e selise se shoqerise eshte: Rr. "Kavajes", ish kombinati ushqimor, Tirane, Shqiperi.
Shoqeria eshte e rregjistruar si person juridik ne Degen e Tatimpaguesve me NIPT J62013013A

Shoqëria disponon kontrata kryesore që i mundësojnë asaj aktivitetin normal si psh kontratat e punësimit, kontratat e qirave, kontratat e telefonave, etj.

Me 31 Dhjetor 2021 shoqeria ka pasur 5 punonjës.

Gjate vitit 2021 nuk ka patur ndryshime në strukturën dhe madhësinë e kapitalit themeltar të shoqërisë. Me 31 Dhjetor 2021 Struktura e kapitalit paraqitet si me poshte:

1.	Kapitali	239,000,000
2.	Vlera e kapitalit të shlyer:	239,000,000
3.	Numri i aksioneve:	283,104
3.1	Vlera nominale:	844,21

AKSIONERET E SHOQERISE

1	Aksionarët Numri i Aksioneve Përqindja e pjesëmarrjes	Lirim Fezollari Me te drejte vote: 253.181,00 89,43%

2	Aksionarët Numri i Aksioneve Përqindja e pjesëmarrjes	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes Me te drejte vote : 13.388,00 4,73%

3	Aksionarët Numri i Aksioneve Përqindja e pjesëmarrjes	Persona te ndryshem Me te drejte vote : 16,535,00 5.84%

4	Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: BUKA sh.a Të Tjera: Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare ne 283 104 aksione, nga keto 53 aksione jane te mbetura (te lira).Per efekt te sistemit numri i aksioneve te kapitalit themeltar ne Seksionin A eshte hedhur 283 051 aksione (283 104 - 53= 283 051 aksione).

2. Politikat kryesore kontabile

Bazat e pergatitjes

Deklarimet financiare te bashkangjitura jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit 9228 date 29 Prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne *Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne fuqi (SKK 2).*

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK te permiresuara kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekononike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha funksionale shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

Aktivet afatshkurtra

Mjetet Monetare perfshijne mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj ne vleren neto.

Investime perfshin Letra me vlerë të njësive ekonomike brenda grupit (aksione) te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, riblerjen e aksioneve të emetuara më parë nga vetë shoqëria aksionare te paraqitura me shumën e paguar për t'i riblerë dhe letra me vlerë të njësive të tjera ekonomike dhe investime të tjera financiare të mbajtura për tregtim (aksione, obligacione, zotërime në fonde investimesh, etj te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Të drejta të arkëtueshme perfshijne kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra (klientë), kërkesat e arkëtueshme nga njësi të tjera të grupit, kërkesat e arkëtueshme nga njësi ekonomike mbi të cilat ushtrohet një ndikim i ndjeshëm apo ku ka investime të tjera financiare, kërkesa të arkëtueshme nga palë të tjera të lidhura (debitorë të tjerë te tjere) te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe llogari/kërkesa të arkëtueshme afatgjata për kapitalin aksionar të autorizuar e të emetuar, por të papaguara.

Inventaret

Inventarët e njësive prodhuese përbëhen nga lëndët e para dhe materialet për konsum, puna në proçes dhe produktet e përfunduara gati për shitje, mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje me pak ose aspak nevojë për ndryshim, që janë inventarë tipike për njësitë tregtare si dhe Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri) te vleresuara sipas Modeli i Kostos ose Modeli i Vlerës së Drejtë.

Aktivet afatgjata, të klasifikuara si të mbajtura për shitje, vlerësohen me vlerën më të ulët midis vlerës së tyre kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Ato paraqiten më vete në pasqyrën e pozicionit financiar

Inventarët maten fillimisht me kosto.

Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes, një njësi ekonomike duhet të matë inventarin me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur.

Inventaret duhet t"i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit. Kërkesa për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t„u përfunduar dhe shitur e detyron njesinë ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh. Zvogëlimet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t„u përfunduar dhe shitur mund të ndodhin në ato raste kur ka një rënie të çmimeve të shitjes ose kur shpenzimet e përfundimit apo shpenzimet direkte të shitjeve janë rritur. Ka dhe raste kur disa produkte dëmtohen përpara se të shiten ose kur disa të tjerë mund të mbahen në sasira të tilla që nuk mund të shiten brenda një periudhë kohe të arsyeshme. Në raste të tilla, kostoja e inventarit duhet të zvogëlohet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t„u përfunduar dhe shitur.Metoda e vleresimit eshte ajo mesatare.

Shpenzime të shtyra paraqesin Shuma të paguara në avancë për shpenzime të periudhave të ardhshme ato vleresohen me Kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara paraqesin Shuma të arkëtueshme në peridha të ardhshme por të konstatuara (të përllogaritura për periudhën ushtrimore) ato vleresohen me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Aktivet afatgjata

Aktive financiare perfshijne tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupi, tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata letrat me vlerë (aksionet, bono të thesarit, obligacione, zotërime në fonde investimesh, etj) që nuk ka gjasa të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm

Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM perfshijne Toka dhe ndërtesa, impiante dhe makineri,të tjera Instalime dhe pajisje qe paraqiten me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe parapagime për aktive materiale dhe në proces qe paraqiten me vlera nominale e shumës së parapaguar.

Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per ndertesat dhe instalimet teknike eshte metoda lineare e cila merr ne konsiderate jeten e dobishme ekonomike, ndersa amortizimi per AAM te tjera llogaritet mbi bazen metodes zbritese.

Aktive Biologjike perfshijne Aktivet biologjike janë kafshë e gjallë ose bimëqe paraqiten sipas Modelit te Kostos

Njohja e aktiveve biologjike bëhet zakonisht në momentin e blerjes. Njohja bëhet gjithashtu kur aktivet biologjike gjenerohen / krijohen nga aktivet ekzistuese. Prodhimi bujqësor, i pandarë (pavjelur, pakorrur, palindur, paqethur, etj) nga një aktiv biologjik, nuk njihet si aktiv më vete. Zakonisht njësia ekonomike bën shpenzime gjatë gjithë jetës së dobishme të një aktivi biologjik. Këto shpenzime kontabilizohen dhe përfshihen si pjesë e vlerës kontabël të aktiveve biologjike, vetëm nëse ato i plotësojnë kriteret e njohjes si aktiv.

Njësia ekonomike mat me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi i akumuluar, ato aktive vlera e drejtë e të cilëve nuk është menjëherë e përcaktueshme, pa kosto apo përpjekje shtesë. Njësia ekonomike mat produktet bujqësore të siguruara nga aktivet e saj biologjike me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në kohën e vjeljes. Një matje e tillë përbën koston e produktit bujqësor në datën e matjes.

Çregjistrimi

Aktivet biologjike çregjistrohen atëherë kur ato shiten. Njësia ekonomike duhet t"i çregjistrojë aktivet biologjike edhe në ato raste kur ato nuk kanë më vlerë ekonomike për të ardhmen (skartohen ose ngordhin). Ndryshimet në vlerën e aktiveve biologjike paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet afatgjata jomateriale (AAJM) janë aktive të identifikueshme jomonetare pa përmbajtje fizike, të mbajtura për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'ua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative ato paraqiten me Kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi

Detyrime afatshkurtra perfshijne Titujt e huamarrjes, Detyrime ndaj institucioneve të kredisë, Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit , Dëftesa të pagueshme, Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit, Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe arkëtime në avancë për porosi te paraqitura me.Vlera nominale e shumës së arkëtuar në avancë, Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore, Të pagueshme për detyrimet tatimore te paraqitura me Kosto e amortizuar

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara perfshijne Detyrimet për shpenzimet e përllogaritura të pagueshme në periudhën pasardhëse dhe paraqiten me kosto te amortizuar.
Të ardhura të shtyra perfshijne Shuma në para (ose aktive të tjera) të marra në avancë, për të cilat ekziston detyrimi i ofrimit të furnizimit me mallra ose shërbime në periudhën pasardhëse. Këtu përfshihen edhe grandet qeveritare ose jo qeveritare dhe paraqiten me kosto te amortizuar.
Provizione paraqesin Detyrim aktual për të cilin shuma apo koha e shlyerjes është e pasigurtë. Vlerësimi i shumës së mundshme të nevojshme për shlyerjen e detyrimit bëhet nga drejtuesit e njësisë

Detyrime afatgjata perfshine Titujt e huamarrjes, Detyrime ndaj institucioneve të kredisë, Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit , Dëftesa të pagueshme, Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit, Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe arkëtime në avancë për porosi te paraqitura me Vleren nominale e shumës së arkëtuar në avancë, Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore, Të pagueshme për detyrimet tatimore te paraqitura me Kosto e amortizuar
te kerkuaeshme per nje afat mbi 12 muaj.
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara-Detyrimet për shpenzimet e përllogaritura të pagueshme pas 12 muajve pas datës së raportimit
Të ardhura të shtyra Shuma në para (ose aktive të tjera) të marra në avancë, për të cilat ekziston detyrimi i ofrimit të furnizimit me mallra ose shërbime përtej 12 muajve pas datës së raportimit **Provizione** Vlera aktuale e shumës së pagesave për t'u bërë

Detyrime tatimore të shtyra shtyra
Detyrime tatimore të shtyra janë shumat e tatimit mbi fitimin, të pagueshme në periudha të ardhshme, të cilat krijohen për shkak të diferencave të përkohshme të tatueshme
Kapitali i Nënshkruar paraqitet *me Vlera kontabël e kapitalit aksionar të emetuar*
Primi i lidhur me kapitalin Arkëtimet mbi vlerën nominale të aksioneve gjatë emetimit të tyre te paraqitura në transaksionet me aksionet e veta - diferenca mes kostos dhe çmimit të shitjes; Në blerjen para afatit të aksioneve të veta - diferenca mes kostos dhe vlerës nominale të aksioneve (minus) koston direkte që lidhet me shitblerjen e aksioneve. Në rastet e kombinimit të bizneseve të njësive nën të njëjtin kontroll - diferenca mes kostos dhe vlerës nominale të aktiveve neto të blera
Rezerva rivlerësimi perfshijne të ardhurat dhe shpenzimet e parealizuara që në përputhje me SKK-të nuk regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (për shembull, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale (SKK 5) rezerva që rrjedhin nga diferencat e kursit të këmbimit në rastin e konsolidimit të njësive të huaja të kontrolluara në përputhje me SKK 9, etj
Rezerva të tjera perfshijne Rezerva ligjore, Rezerva statutore
Fitimi i pashpërndarë paraqesin Fitimi/humbja e akumuluar nga periudhat kontabël të mëparshme që as nuk është paguar si dividend dhe as nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër nga njësia ekonomike (për shembull për zmadhimin e kapitalit aksionar ose rezervave)

Njohja e te ardhurave
Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit.
Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.
Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).

Shpenzimet

Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese që rezultojnë në pakësimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe që zvogëlojnë kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me shpërndarjet te pjesëmarrësit e kapitalit. Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Një njësi ekonomike duhet të njohë shpenzimet në pasqyrën e performancës financiare kur lind një ulje në përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhet me një pakësim të një aktivi ose rritje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarjuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

Te ardhurat dhe shpenzimet finaciare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne diten e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm pët të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

Transaksionet me monedhat e huaja

Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e konsoliduara financiare raportohen ne LEKE shqiptar (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
1 EUR	120.76	123.7
1 USD	106.54	100.84

3. Aktivet monetare perfaqesojne gjendjen ne banke dhe ne arke ne fund te vitit. Per llogarite ne valute eshte bere azhornimi me kursin e dates 31.12.2021 dhe 31.12.2020 dhe ato detajohen si me poshte:

	31/12/2021	31/12/2020
Arka	2,764	1,900
Banka	4,555,500	5,083,038
Total	**4,558,264**	**5,084,938**

4. **Të drejta e arkëtueshme** te shoqerise me 31.12.2021 dhe 31.12.2020 detajohen si me poshte:

	31/12/2021	31/12/2020
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	19,227,945	18,313,259
Të tjera	66,691,252	67,425,514
	85,919,197	**85,738,773**

Nga te cilat :

4.a Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit perfaqesojne te drejta ndaj klienteve me 31.12.2021 dhe 31.12.2020.

4.b Te tjera te drejta te arketueshme me 31.12.2021 detajohen si me poshte:

	31/12/2021	31/12/2020
Tvsh per tu rregulluar	6,613,038	7,004,785
Te drejta ndaj Tobacco Holding Group	59,958,442	60,300,958
Parapagim i tatimit mbi fitimin	119772	119772
	66,691,252	**67,425,514**

5. **Aktivet Afatgjata Materiale** me 31.12.2021 paraqiten me vleren neto.

Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2021

Emertimi	Gjendje 2021-01-01	Shtesa nga rivleresimet	Shtesa	Pakesime	Gjendje 2021-12-31
Toka dhe ndërtesa	394,927,121				394,927,121
Makineri,paisje	25,501,943				25,501,943
Mjete transporti	1,334,468				1,334,468
Pajisje kompjuterike	823,163		26,433		849,596
Pajisje Zyre	1,950,989				1,950,989
Te tjera	9,793,753				9,793,753
TOTALI	434,331,437	0	0	0	434,357,870

Amortizimi A.A.Materiale 2021

Emertimi	Gjendje 2021-01-01	Shtesa nga rivleresimet	Shtesa	Pakesime	Gjendje 2021-12-31
Toka dhe ndërtesa	37,902,173				37,902,173
Makineri,paisje,vegla	13,118,881		254,885		13,373,766
Mjete transporti	1,003,402		40,035		1,043,437
Pajisje kompjuterike	589,601		72,279		661,880
Pajisje Zyre	1,107,767		186,308		1,294,075
Te tjera	597,241		459,826		1,057,067
TOTALI	54,319,066	0	1,013,332	0	55,332,399

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2021

Emertimi	Gjendje 2021-01-01	Shtesa nga rivleresimet	Shtesa	Pakesime	Gjendje 2021-12-31
Toka dhe ndërtesa	357,024,948	0	-	0	357,024,948
Makineri,paisje,vegla	12,383,062	0	(254,885)	0	12,128,177
Mjete transporti	331,066	0	(40,035)	0	291,031
Pajisje kompjuterike	233,561	0	(45,846)	0	187,715
Pajisje Zyre	843,221	0	(186,308)	0	656,914
Te tjera	9,196,512	0	(459,826)	0	8,736,687
TOTALI	380,012,371	0	(986,899)	0	379,025,472

6.Detyrime afatshkurtra perfshijne Titujt e huamarrjes, Detyrime ndaj institucioneve të kredisë, Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit , Dëftesa të pagueshme, Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit, Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe arkëtime në avancë për porosi.

	31/12/2021	31/12/2020
Arkëtime në avancë për porosi	300,000	300,000
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,217,416	1,144,694
Të pag. ndaj punonj dhe sigurimeve shoqërore	85,078	89,552
Të pagueshme për detyrimet tatimore	30,942	30,775
Totali	**1,633,436**	**1,565,021**

7.a Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit paraqet deryrimet ndaj furnitoreve me 31.12.2021.

7.b Të pagueshme për detyrimet tatimore detajohet si me poshte :

	31/12/2021	31/12/2020
Shteti Tatim Ardhura Page,	20,142	19,975
Tatim ne burim te ardhura	10,800	10,800
	30,942	**30,775**

8. Kapitali i Nënshkruar paraqitet me Vlera kontabël e kapitalit aksionar të emetuar ne vleren 239,000,000 Leke.

Primi i lidhur me kapitalin Arkëtimet mbi vlerën nominale të aksioneve gjatë emetimit të tyre te paraqitura në transaksionet me aksionet e veta - diferenca mes kostos dhe çmimit të shitjes.

Rezerva të tjera perfshijne Rezerva ligjore, Rezerva statutore

Rezerva të tjera	**1,894,965**
Rezerva ligjore	**643,708**

Fitimi i pashpërndarë paraqesin Fitimi/humbja e akumuluar nga periudhat kontabël të mëparshme që as nuk është paguar si dividend dhe as nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër nga njësia ekonomike (për shembull për zmadhimin e kapitalit aksionar ose rezervave) .

Gjithashtu ne fitime te pashperndare eshte perfshire edhe Rezerva nga rivleresimi ne vleren 130,959,148 leke, e cila i perket pasurise se rivleresuar sipas ligjit 81/2016 dhe te shitur gjate vitit 2017, ne perputhje me SKK5 par. 28 sipas te cilit "Teprica nga rivlerësimi, e përfshirë në kapitalet e veta për një element të AAM-së, duhet të kalohet te fitimet e pashpërndara përgjatë jetës së dobishme të aktivit afatgjatë material". Per vleresimin e pasurise eshte ndjekur procedura ligjore e percaktuar me ligj dhe eshte paguar tatimi ne vleren 3% te vleres se vleresuar.

Fitimi / humbje te mbartura	228,022,699
Rezerva nga rivleresimi e kaluar ne Fitim te pashperndare per token e shitur gjate vitit 2020	(1,701,576)
Fitimi i pashpërndarë	**226,321,123**

Humbja i i vitit ushtrimor ne vleren 1,701,576 Leke.

9. Te ardhurat

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit.

	Per Vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Per Vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Qera	13,315,220	14,094,237
Parkim	1,354,348	1,043,084
Te tjera utilitete	630,823	544,642
Te ardhura nga shitja e AQT	-	-
	15,300,390	**15,681,963**

10. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese që rezultojnë në pakësimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe që zvogëlojnë kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me shpërndarjet te pjesëmarrësit e kapitalit. Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve.

Shpenzimi	Per Vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Per Vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019
Karburant	0	0
Blerje energji, avull, uje	1,520,086	1,566,462
Mirembajtje & riparim automjet	0	0
Mirembajtje&riparim per Com	6,000	0
Roje	5,212,800	4,953,600
Kancelari	7,080	8,020
Materiale per IT	64,522	2600
Te ndryshme	233,861	154,426
Sherbime postare dhe telekomunikacioni	80,387	80,167
Sherbime bankare	27,392	23,495
Taksa per makinat	0	0
Te tjera Tatim Taksa	3,089,527	1,741,570
Vlera kontabel e aktive te qen	0	0
subvencione	0	
Pritje percjellje	20,000	
Konsulenca	290,400	288,000
Penalitete, gjoba e demshperbl	0	0
Totali	**10,552,055**	**8,818,341**

11. Shpenzime financiare kane lidhje me fitime humbje nga kurset e kembimit .

12.Fitimi humbja e vitit ushtrimor 2021 pas tatimeve paraqitet si me poshte:

	Viti 2021	Viti 2019
Fitimi i ushtrimit	(1,701,576)	(133,823)
Shpenzime te pa zbriteshme	0	
Fitimi para tatimit		
Tatimi mbi fitimin		
Fitimi /humbja neto e vitit	**(1,701,576)**	**(133,823)**